

Regjimi i vizave për Kosovën: A do t'i japë fund BE-ja kësaj agonie të gjatë?

Regjimi i vizave për Kosovën: A do t'i japë fund BE-ja kësaj agonie të gjatë?

Ky raport është mbështetur nga:

Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë




Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analizat në këtë raport janë vetëm të Grupit për Ballkan dhe nuk reflektojnë qëndrimin e donatorit.

Regjimi i vizave për Kosovën: A do t'i japë fund BE-ja kësaj agonie të gjatë?

Dhjetë vjet nga fillimi i dialogut për viza dhe katër vite nga zbatimi i kritereve, Kosova ende mbetet në pritje të regjimit pa viza me BE-në.¹ Në dekadën e fundit, Kosova ka arritur përparim të dukshëm në përmbushjen e një liste të gjatë të kritereve lidhur me migrimin, sigurinë dhe luftën kundër krimit të organizuar e korrupsionit dhe mbi të gjitha ka përmbushur kushtin e paprecedentë të demarkacionit të kufirit me Malin e Zi.² Megjithatë, kosovarët vazhdojnë të presin në radhë të gjata përpara ambasadave [të vendeve të BE-së/Zonës Shengen] për tu pajisur me vizë.³

Shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor po shijojnë përfitimet e liberalizimit të vizave për më shumë se një dekadë. Kosova në anën tjetër e ka filluar dialogun për viza në janar të vitit 2012. Kosovës i është dhënë një Udhërrëfyes Gjithëpërfshirës për Liberalizimin e Vizave me 95 kritere, që mbulon fushat e Ri-pranimit dhe Ri-integrimit, Sigurisë së Dokumenteve, Menaxhimit të Kufirit dhe Migracionit, Rendit Publik dhe Sigurisë, dhe të Drejtave Themelore lidhur me Lirinë e Lëvizjes.⁴ Duke lënë anash faktin që Kosovës i është dashur të përmbush dy herë më shumë kritere se sa vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi me nga rreth 40-45 kritere), ajo sot mbetet i vetmi shtet i izoluar në rajon. Mosnjohja nga pesë shtete anëtare (SHA) të Bashkimit Evropian përbën një barrë shtesë në këtë drejtim: Kosovës i është dashur të nënshkruaj marrëveshje bilaterale të ri-pranimit me shtetet veç e veç ose me grupe shtetesh anëtare, në vend që të nënshkruante marrëveshje me BE-në si tërësi (18 marrëveshje me 20 vende të BE-së/Shengen).⁵ Përveç kësaj, për dallim prej shteteve fqinje, Kosovës kurrë nuk iu ofrua ndonjë marrëveshje për lehtësimin e marrjes së vizave, gjë që do t'u ofronte aplikantëve procedura më të thjeshta (p.sh. uljen e tarifës së vizës, lëshimin e vizave me shumë hyrje për kategori specifike të aplikantëve dhe kohë më të shkurtra të procesimit).⁶



Burimi: Politika evropiane e fqinjësisë dhe zgjerimit, Komisioni Evropian.⁷

Pas fillimit të dialogut për viza, Komisioni Evropian (Komisioni) miratoi tri raporte për progresin e Kosovës në dialogun për viza (8 shkurt 2013; 24 korrik 2014; dhe 18 dhjetor 2015). Raporti i katërt (4 maj 2016) erdhi me propozimin për heqjen e regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës pas përmbushjes së dy kritereve të mbetura - ratifikimi i marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi dhe përparimi i shënuar në luftën kundër krimit dhe korrupsionit.⁸

Me përmbushjen e dy kërkesave të mbetura, në korrik të vitit 2018, Komisioni dha dritën jeshile të shumëpritur për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.⁹ Propozimi i Komisionit mori votat pozitive të Komitetit të Parlamentit Evropian mbi Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme (LIBE), duke shënuar në të njëjtën kohë hapjen e negociatave ndër-institucionale për përfundimin e procesit.¹⁰

1 Raporti i Grupit për Ballkan, Rruga e vonuar dhe e gjatë e Kosovës drejt udhëtimit pa viza, 22 prill 2018.

2 Drejtorja e përgjithshme për fqinjësinë dhe negociatat e zgjerimit; 19 tetor 2021, në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2021_en.

3 Rregullorja e tekstit të konsoliduar (BE) 2018/1806 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 nëntor 2018 që liston vendet e treta shtetasit e të cilëve duhet të kenë viza kur kalojnë kufijtë e jashtëm dhe ato vende shtetasit e të cilëve janë të përjashtuar nga kjo kërkesë, në <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A02018R1806-20210101>.

4 Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave me Kosovën*, 2012, në https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/visa_liberalisation_with_kosovo_roadmap.pdf.

5 Liberalizimi i vizave: Saga e Kosovës në rrugën drejt BE-së, KFOS, në <https://kfos.org/en/publications/114/visa-liberalization-kosovos-saga-eu-path>.

6 Në vitin 2007, Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi nënshkruan marrëveshje lehtësimi me BE-në. Marrëveshjet e lehtësimit ishin pjesë e marrëveshjeve të ri-pranimit që çdo vend do të duhej të nënshkruante me vendet e BE-së për t'i lejuar ato të kthenin migrantët që kanë mbërritur ilegalisht në vendet e tyre të origjinës ose tranzitit. Komisioni Evropian, në https://home-affairs.ec.europa.eu/policies/schengen-borders-and-visa/visa-policy_en.

7 Për më shumë shihni në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/kosovo_en

8 Komisioni Evropian propozon udhëtimit pa viza për qytetarët e Kosovës, Komunikatë për shtyp e Komisionit Evropian, 4 maj, 2016, Bruksel. Propozimi i Komisionit i referohet ndryshimit të Rregullores (KE) 1806/2018, [që do të miratohej nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian] gjë që e vendosë Kosovën në Aneksin e entiteteve pa viza. Kjo rregullorë rendit vendet e treta, shtetasit e të cilëve duhet të kenë vizë kur kalojnë kufijtë e jashtëm dhe vendet shtetasit e të cilëve janë të përjashtuar nga kjo kërkesë. Për më shumë, shih raportin e Grupit për Ballkan - Rruga e vonuar dhe e gjatë e Kosovës drejt udhëtimit pa viza, 22 prill 2018.

9 Liberalizimi i vizave: Komisioni Evropian konfirmon se Kosova i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara, faqja zyrtare e EEAS, 18 korrik 2018, në: https://www.eeas.europa.eu/node/48608_en.

10 Komiteti i Parlamentit Evropian për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme (LIBE), Twitter, 30 gusht, 2018, në https://twitter.com/EP_Justice/status/1035089993683886081.

Me 420 vota pro, 186 kundër dhe 20 abstenime, Parlamenti Evropian (Parlamenti) konfirmoi gatishmërinë e tij për të shtyrë tutje këtë çështje, gjë që nuk arriti të marrë shumicën e kërkuar të votave të Këshillit të Bashkimit Evropian.¹¹

Perspektiva e liberalizimit të vizave për Ballkanin Perëndimor (BP) derivon nga Samiti i Selanikut i 10 qershorit të vitit 2003, i cili pohoi perspektivën evropiane të shteteve të BP-së dhe hodhi themelet për udhëtimin e tyre eventual pa viza në Evropë.¹²

'BE-ja është e vetëdijshme për rëndësinë që popujt dhe qeveritë në Ballkanin Perëndimor i kushtojnë perspektivës së liberalizimit të vizave. Progresi varet nga zbatimi i reformave të thella nga ana e këtyre vendeve në fusha të tilla si forcimi i shtetit të së drejtës, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, migracioni i paligjshëm dhe forcimi i kapaciteteve administrative në kontrollin e kufijve dhe sigurinë e dokumenteve'.¹³

Momentumi i humbur dhe shpresa e ringjallur

Me humbjen e momentumit për liberalizimin e vizave si një paketë me Gjeorgjinë dhe Ukrainën në vitin 2018, kërkesa e Kosovës për heqje të regjimit të vizave ka rënë në vesh të shurdhër.¹⁴ Kriza e brendshme politike për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, krahas mosmarrëveshjeve rreth procesit të dialogut me Serbinë, ka kontribuar në 'humbjen e trenit'.¹⁵ Përveç kësaj, skepticizmi i disa vendeve anëtare të BE-së për përkushtimin e Kosovës në luftën kundër korrupsionit si dhe 'lodhja nga zgjerimi' e BE-së e kanë zgjatur padrejtësisht procesin.¹⁶

Komisioni ka vazhduar të mbaj qëndrimin e korrikut të vitit 2018 lidhur me përmbushjen e të gjitha kriterëve për liberalizimin e vizave nga ana e Kosovës, veçanërisht gjatë bisedimeve të fundit kur u shqyrtua mundësia e prezantimit të një udhërrëfyesi shtesë për Kosovën.¹⁷ Megjithatë, Komisioni dhe Parlamenti Evropian deri më tani nuk kanë arritur të bindin Këshillin, gjë që ka reflektuar një disharmoni të rëndë brenda BE-së.

Pas luftës në Ukrainë dhe kërcënimeve të reja mbi sigurinë, prioritetet kanë ndryshuar dhe interesi i BE-së për Ballkanin Perëndimor është rritur. Duke parë se sa lehtësisht mund të dështojnë përpjekjet shumë-dekadëshe në ndërtimin e paqes si dhe nevojën urgjente për të mbajtur afër vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Partneritetin Lindor, BE-ja ka ringjallur perspektivën për zgjerim. Aplikimi i Ukrainës dhe Moldavisë për një anëtarësim të shpejtë në BE është tregues i dukshëm se procedurat dhe vendimet e tilla shpesh janë politike më shumë se teknike.¹⁸

Sa i përket Kosovës, BE-ja duhet të kalojë provën e parë të madhe duke hequr regjimin e vizave për qytetarët e saj që të parandaloj rënien e kredibilitetit të BE-së në vend.¹⁹ Çka është më e rëndësishme, Kosova me qeverinë e re ka vazhduar të bëjë përparim shtesë në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, mjaftueshëm për të bindur shtetet anëtare hezituese mbi angazhimin e saj në këtë fushë.

11 Jozwiak, Rikard. Parlamenti Evropian voton në favor të bisedimeve për liberalizimin e vizave për Kosovën, Radio Evropa e Lirë/"Radio Liberty", 13 shtator 2018, në: <https://www.rferl.org/a/european-parliament-votes-in-favor-of-talks-on-visa-liberalization-for-kosovo/29487932.html>. Sistemi i Votimit, Këshilli i Bashkimit Evropian, në <https://www.consilium.europa.eu/en/council-eu/voting-system/qualified-majority/>.

12 Për më shumë, shih raportin e Grupit për Ballkan, Rruga e vonuar dhe e gjatë e Kosovës drejt udhëtimit pa viza, 22 prill 2018 dhe Agjenda e Selanikut, Konkluzionet e Këshillit të Ballkanit Perëndimor, 16 qershor 2003, në <http://www.pascal-hector.de/Vertiefung-Erweiterung-Dateien/14a-ER-2003%20Thessaloniki-Agenda-Westlicher-Balkan.pdf>

13 Agjenda e Selanikut, Konkluzionet e Këshillit të Ballkanit Perëndimor, 16 qershor, 2003, në <http://www.pascal-hector.de/Vertiefung-Erweiterung-Dateien/14a-ER-2003%20Thessaloniki-Agenda-Westlicher-Balkan.pdf>.

14 Raporti i Grupit për Ballkan, Rruga e vonuar dhe e gjatë e Kosovës drejt udhëtimit pa viza, 22 prill 2018.

15 Qeveria e Kosovës bie mbi marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, Euroactiv, 11 maj 2017, në <https://www.euroactiv.com/section/enlargement/news/kosovo-government-falls-over-border-demarcation-deal-with-montenegro/>.

16 Holanda kundër liberalizimit të vizave për shkak të skepticizmit në luftën kundër korrupsionit, Euronews Albania, 4 qershor 2021, në <https://euronews.al/en/kosovo/2021/06/04/the-netherlands-against-visa-liberalization-amid-skepticism-on-corruption-fight-reports-local-media/>.

17 Liberalizimi i vizave - Komisioni Evropian thotë se nuk do të ketë udhërrëfyesi shtesë për Kosovën, Telegrafi, 28 June 2022, at <https://telegafi.com/liberalizimi-vizave-komisioni-evropian-thote-se-nuk-te-kete-udherrefyese-shtese-per-kosoven/>. EU Commission maintained the same position in the Country Reports from 2018-2021.

18 Rekomandimet e Komisionit të BE-së për statusin e kandidatit të Ukrainës në BE, EEAS, 17 qershor 2022, në https://www.eeas.europa.eu/delegations/ukraine/eu-commissions-recommendations-ukraines-eu-candidate-status_en?s=232.

19 Intervistat e Grupit për Ballkan me qytetarë dhe biznese, gusht-shtator 2022.

- o Një rritje prej **13.4% në bastisjet e policisë** në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020;²⁰
- o Një rritje prej **75%** të aktiviteteve për **shpartallimin e grupeve të krimit të organizuar**;²¹
- o Një rritje prej **85%** të **aktakuzave për krime ekonomike dhe korrupsion** krahasuar me një vit më parë;²²
- o Krijimi i **një mekanizmi të ri gjurmues për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar**.
Numri i rasteve të synuara është rritur nga 31 në vitin 2016 në 82 në vitin 2022;²³
- o Rënditja **në vendin e parë për Ballkanin Perëndimor** nga Raporti Botëror i Drejtësisë mbi Sundimin e Ligjit;²⁴
- o Përmirësimi i pozicionit në Indeksin e Transparency International me 17 vende/ **dhe renditja në vendin e dytë me pikët më të larta në Ballkanin Perëndimor**;²⁵
- o **Janë iniciuar 726 raste të reja** me 792 persona të arrestuar dhe 541 aktakuza të ngritura ndaj 738 personave të dyshuar në fushën e **parandalimit dhe luftimit të drogës**.²⁶
- o **Një rënie e rasteve të ri-pranimit** nga 2,621 në vitin 2018 në 342 në vitin 2022.²⁷

Për më shumë, numri i azil-kërkuesve ka rënë nga 4,720 në vitin 2018 në 2,345 në vitin 2021; gjë që është përbën një tjetër lajm të mirë për BE-në.²⁸

Në këtë klimë shpresash të ringjallura (korrik 2022), tekta skepticizmi i disa vendeve anëtare të BE-së po zbehej, Parlamenti Evropian i bëri thirrje përsëri Këshillit që urgjentisht të heq regjimin e vizave për Kosovën.²⁹ Më 16 shtator të vitit 2022, Qeveria mori komente më inkurajuese nga deklarata e përbashkët e Polonisë, Francës dhe Gjermanisë, me ç' rast u vërehet një ndryshim pozitiv i qëndrimeve, veçanërisht nga ana e Francës.³⁰

'Ne bëjmë thirrje për progres në lidhje me liberalizimin e vizave për Kosovën. Vendet tona janë të përkushtuara fuqishëm ndaj Procesit të Berlinit si një mjet shtesë për të nxitur bashkëpunimin rajonal dhe anëtarësimin në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor; ne vlerësojmë lartë rëndësinë e zbatimit të vendimit historik nga ana e gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor për të krijuar një treg të përbashkët rajonal'.

Holanda, e cila ishte gjithashtu në sinkron me Francën sa i përket perspektivës për integrim evropian të BP-së, gjithashtu ka shfaqur një qëndrim të ndryshuar.³¹ Tani që shanset janë në favor të një zhvillimi pozitiv gjatë Presidencës Çeke të Këshillit si dhe duke pasur parasysh zotimin e deklaruar për të shtyrë përpara liberalizimin e vizave [për Kosovën], Kosova po pret me padurim takimin e Grupit Punues për Vizat më 13 tetor 2022.³²

Pas Samitit të BE-së që u mbajt në qershor të vitit 2022, ekziston një gatishmëri e përgjithshme midis vendeve anëtare të BE-së për të ecur përpara në këtë çështje.³³ Në gusht dhe shtator, Drejtorja e Përgjithshme për Migrim dhe Çështje të Brendshme (DG Home) në bashkëpunim me DG NEAR vlerësuan progresin e Kosovës në përmbushjen e kritereve.³⁴

20 Raporti Vjetor i Punës i Policisë së Kosovës, Janar-Dhjetor 2021, at <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2022/03/RAPORTI-VJETOR-I-PUNES%3C%8B-S%3C%8B-KOSOV%3C%8B-shqip.pdf>.

21 Ibid.

22 Ibid.

23 Ibid.

24 Indeksi i Sundimit të Ligjit të WJP, në <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/Kosovo>.

25 Indeksi i perceptimit të korrupsionit, Transparency International, në <https://www.transparency.org/en/cpi/2021/index/ksv>.

26 Raporti Vjetor i Punës i Policisë së Kosovës, Janar-Dhjetor 2021, at <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2022/03/RAPORTI-VJETOR-I-PUNES%3C%8B-S%3C%8B-KOSOV%3C%8B-shqip.pdf>.

27 Të dhënat nga Qeveria e Kosovës, shtator 2022.

28 Të dhëna nga Zyra e Kryeministrit, shtator 2022.

29 Parlamenti Evropian miraton raportet për BiH, Kosovën dhe Serbinë, Ballkanin Perëndimor Evropian, 6 korrik 2022, në <https://europeanwesternbalkans.com/2022/07/06/european-parliament-adopts-reports-on-bih-kosovo-and-serbia/>.

30 Deklaratë e përbashkët e Ministrave për Çështjet Evropiane të Trekëndëshit të Vajmarit, Ministria e Jashtme Federale Gjermane, në 16 shtator, 2022, në: <https://www.auswaertiges-amt.de/en/newsroom/news/weimar-triangle/2552384?fbclid=IwAR39cQvvtjb1PzpsnA8ozrykeRwSt4Kut6iKpCqPQlavbPBJKAZO4mGMikw>.

31 Holanda jep sinjale pozitive për liberalizimin e vizave për Kosovën, Telegrafi, 22 June 2022, at <https://telegrafi.com/holanda-ndryshon-disponim-per-liberalizimin-e-vizave-per-kosoven/>.

32 Intervistë e Grupit për Ballkan me një ekspert të politikave, shtator 2022, Prishtinë.

33 Intervistë e Grupit për Ballkan me zyrën e Kryeministrit, shtator 2022, Prishtinë.

34 Ibid. Qeveria e Kosovës i dërgoi një informacion të detajuar teknik Komisionit të BE-së (DG HOME), më 12 gusht 2022, si një raport i përditësuar mbi Udhërrëfyesin e BE-së mbi vizat që mbulon vitet 2018-2022 dhe tregon trende pozitive në të gjithë kapitujt e udhërrëfyesit mbi vizat.

Raporti i tyre, në formën e një dokumenti teknik jo zyrtar, do të shërbejë si bazë për hapjen e diskutimeve mbi regjimin pa viza për Kosovën gjatë takimit të Grupit Punues për Vizat (13 tetor 2022), ku gjithashtu i ftuar është edhe COWEB (Grupi Punues për Rajonin e Ballkanit Perëndimor).³⁵

Përmes këtij raporti, Komisioni konfirmon progresin e Kosovës në fushat kryesore (siç janë identifikuar në udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave) dhe duke i'u referuar rekomandimit të vitit 2018 për liberalizimin e vizave për Kosovën, i bën thirrje Shteteve Anëtare që të heqin regjimin e vizave për qëndrim të shkurtër për shtetasit e Kosovës.³⁶

Megjithatë, disa nga vendet që nuk e njohin Kosovën (veçanërisht Spanja dhe Qiproja) të cilat refuzojnë të pranojnë pasaportat e Kosovës, nuk janë deklaruar ende.³⁷ Prandaj, BE-ja duhet të insistojë në zbatimin e modalitetit të MSA-së për Kosovën dhe të parandalojë shtetet nga derogimi.

Takimi i 13 tetorit është vendimtar për Kosovën, meqë më në fund do të shënoj ri-fillimin e procesit të liberalizimit të vizave. Megjithatë, procedura nuk përfundon këtu. Nëse Grupi Punues për Vizat dhe Grupi Punues për Rajonin e Ballkanit Perëndimor (COWEB) arrijnë një konsensus, atëherë do të pasojnë një sërë veprimesh dhe procedurash që mund të zgjasin deri në disa muaj.³⁸

35 Intervistë e Grupit për Ballkan me Zyrën e Kryeministrit, shtator 2022, Prishtinë; Liberalizimi i vizave për Kosovën në rend dite në BE më 13 tetor – në rast të vendimit pozitiv, kur do të mundën qytetarët të udhëtojnë pa viza, Telegrafi, 27 shtator 2022, në: <https://telegafi.com/liberalizimi-vizave-per-kosoven-ne-rend-dite-ne-13-tetor-ne-rast-te-vendimit-pozitiv-kur-te-munden-qytetaret-te-udhetajne-pa-viza/>

36 Intervistë e Grupit për Ballkan me Zyrën e Kryeministrit, shtator 2022.

37 Korrespondencë e Grupit për Ballkan me një zyrtar të BE-së në Bruksel, 07 tetor 2022.

38 Intervistë e Grupit për Ballkan me Zyrën e Kryeministrit, shtator, 2022 Prishtinë.

10 HAPAT PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR KOSOVËN

7 Hapa të pakompletuar

1 Komisioni u'a dërgon Parlamentit Evropian dhe Këshillit propozimin për liberalizimin e vizave

1 **DONE**

Parlamenti e shqyrton propozimin e Komisionit dhe cakton një raportues për të përgatitur një raport i cili vlerësohet nga Komiteti i Parlamentit Evropian për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme (LIBE)

2 **DONE**

LIBE e voton raportin e raportuesit me shumicë të thjeshtë votash, duke miratuar rekomandimin për liberalizimin e vizave për Kosovën. Në të njëjtën kohë, LIBE e miraton hapjen e negociatave ndër-institucionale e njohur si "Trialogue" (tre-palëshe).

3 **DONE**

Paralelisht, me marrjen e propozimit nga Komisioni, Këshilli fillon përgatitjet. Diskutimi zhvillohet në Grupin Punues për Vizat dhe Grupin Punues për rajonin e Ballkanit Perëndimor – COWEB. Nëse të dy grupet arrijnë një konsensus, propozimi shkon në COREPER.

4

Kosova ka ngecur në këtë hap që nga viti 2020.

Në nivel të COREPER, Këshilli miraton pozicionin negociues për negociatat ndër-institucionale (dialog).

5

Tri institucionet e BE-së (Këshilli, Parlamenti dhe Komisioni) zhvillojnë negociata ndër-institucionale.

6

LIBE dhe COREPER votojnë propozimin për ndryshimin e Rregullores Nr. 1806/2018 për ta zhvendosur Kosovën nën Aneksin e shteteve pa regjim të vizave.

7

Parlamenti Evropian voton në seancën plenare propozimin për ndryshimin e Rregullores 1806/2018.

8

Pas miratimit nga Parlamenti Evropian, Këshilli miraton ndryshimin e rregullores.

9

Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Ministrave nënshkruajnë aktin përfundimtar. Tre javë më vonë akti publikohet në gazetën zyrtare të BE-së. 20 ditë më vonë qytetarët e Kosovës mund të udhëtojnë pa viza në zonën Shengen.


10

Çmimi i lëvizjes në BE

Katër vite nga raporti i Komisionit Evropian mbi përmbushjen e kriterëve për viza, kosovarët ende përballen me procedura të tej zgjatura dhe të kushtueshme për pajisje me vizë afatshkurtër për udhëtim në vendet e BE-së. Në vitin 2015, kur Kosova nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me BE-në, kjo e fundit bëri deklaratë të forta se si një marrëveshje e tillë do ta vendoste Kosovën në rrugën drejt rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe se e njëjta do të krijonte mundësi punësimi për qytetarët e saj.³⁹ Por pa lëvizjen e lirë të njerëzve, Kosova nuk ka arritur të shfrytëzojë të gjitha përfitimet që burojnë nga lëvizja e lirë e mallrave dhe shërbimeve që u mundësova përmes MSA-së.

Pavarësisht premtimeve, BE-ja dhe shtetet anëtare vazhduan të vënë në pikëpyetje rëndësinë e liberalizimit të vizave për Kosovën, duke e lënë të zhgënjyer një nga popujt më pro-evropian.⁴⁰ Shteti i vogël i Kosovës, që gjendet në Evropën Juglindore, sot është vendi më i izoluar në kontinent. Kosova ka një popullsi prej jo më shumë se 1.8 milionë banorësh dhe përqindjen më të lartë të të rinjve në mesin e vendeve kandidatë dhe atyre potencialisht kandidatë për në BE.⁴¹

Të dhënat nga sondazhi i Grupit për Ballkan (që përfshinë 220 të anketuar) tregojnë se kosovarët janë të afektuar financiarisht dhe emocionalisht nga regjimi i vizave, gjë që ka kufizuar padrejtësisht mundësitë e tyre krahasuar me fqinjët.⁴² Të pyetur për qëllimin e vizitës së tyre jashtë vendit, 60% e të anketuarve janë përgjigjur se kanë për qëllim të udhëtonin për turizëm, 29% për biznes dhe 19% prej tyre për arsye të tjera.



VisaMetric e Gjermanisë tarifon 30 euro për termin dhe 30 euro për dërgimin e pasaportës me postë.⁴³

Bazuar në përgjigjet e të anketuarve, një qytetar i Kosovës paguan një çmim mesatar prej 165 eurosh për të marrë një vizë, e që në shumicën e rasteve mbulon një qëndrim shumë të shkurtër në vendet e zonës Shengen.

Kostoja rritet nëse aplikanti i drejtohet një agjencie që ofron asistencën e nevojshme për të aplikuar dhe/ose caktimin e terminit të shpejtë për vizë, që rezulton në tarifa shtesë të cilat variojnë nga 20 deri në 300€. Për më shumë, ambasadat kryesore që lëshojnë numrin më të madh të vizave Shengen kanë kontraktuar ofruesit e shërbimeve si "TLS" për Zvicrën ose "VisaMetric" për Gjermaninë, për të trajtuar aplikimet për viza afatshkurtra në vendet e tyre përkatëse. Sikur të mos mjaftonin tarifat ekzistuese për aplikim për viza, këta ofrues shërbimesh kërkojnë pagesë shtesë për caktim të një termini dhe/ose dërgim të pasaportës me postë.

'Disa të anketuar, kryesisht familjarë, raportuan se kishin paguar individualisht për secilin dërgim të pasaportës me postë, edhe në rastet kur të gjitha pasaportat e tyre ishin dërguar përmes një pakete të vetme në një adresë të përbashkët.'

39 Nënshkruhet Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, Këshilli i Bashkimit Evropian, 27 tetor 2015, në <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/27/kosovo-eu-stabilisation-association-agreement/>

40 Franca, Gjermania dhe Holanda kundërshtuan liberalizimin e vizave, RTK Live, 13 korrik 2020 në <https://www.rtklive.com/en/news-single.php?ID=17031>.

41 Vendet e zgjerimit - statistikat e popullsisë, Eurostat, në https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Enlargement_countries_-_population_statistics.

42 Grupi për Ballkan ka realizuar një sondazh me qytetarët e Kosovës gjatë aplikimit për vizë pranë shërbimeve konsullare të ambasadave të huaja në Kosovë (vendet e BE-së). Sondazhi ofron informacion vetëm mbi aplikimet për viza me qëndrim të shkurtër. Informacioni i mbledhur ka për qëllim paraqitjen e dëmeve materiale dhe jo materiale që iu shkaktohen qytetarëve si rezultat i tej zgjatjes së procesit të liberalizimit të vizave. Anketa është realizuar në formën e intervistave ballë për ballë nga një grup hulumtuesish në terren, nga data 19 deri më 26 shtator 2022, në Prishtinë. Pyetjet ishin të hapura, dhe u hartuan si të tilla për të lejuar të anketuarit të shprehnin mendimet e tyre pa kufizime. Sondazhi ka përfshirë gjithsej 220 të anketuar, perceptimet e të cilëve janë analizuar dhe paraqitur në kapitullin: Çmimi i lëvizjes në Evropë. Të dhënat e paraqitura në këtë kapitull përfaqësojnë vetëm perceptimet e të anketuarve dhe synojnë të hedhin dritë mbi disa nga sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen kosovarët gjatë marrjes së vizave.


43 Për tarifat e VisaMetric, shih <https://www.visametric.com/Kosovo/Germany/en/p/fees>. Për tarifat e TLS, shih https://ch.tlscontact.com/xk/prn/page.php?pid=application_fees




Duke marrë parasysh faktorë të tillë si mos reagimin e ambasadave, tarifën e aplikimit dhe pritjen e gjatë për të caktuar një termin, qytetarët janë gati të paguajnë çdo shumë tjetër të shtuar, me shpresën që të minimizojnë shanset e refuzimeve për shkak të ndonjë gabimi të mundshëm procedural.

Megjithatë, kostoja nuk është e vetmja barrë, pavarësisht se sa e rëndë mund të jetë. Shumica dërmuese e të anketuarve listuan sfidat kryesore ndaj procesit të aplikimit për vizë si më poshtë:


- Një kohë pritjeje prej 1-6 muajsh për caktimin e një termini për vizë;
- Orë të gjata pritjeje për dorëzimin e dokumenteve;
- Kostoja e lartë e aplikimit;
- Validiteti i shkurtër e vizës së lëshuar (nga disa ditë deri në disa javë);
- Refuzime të paarsyeshme;
- Një listë e gjatë e dokumenteve që duhen dorëzuar për çdo aplikim;
- Informim jo i duhur në lidhje me të gjitha dokumentet e kërkuara/procedurat e nevojshme;
- Mos reagimi i ambasadave/shërbimeve konsullore në rast të kërimit të informacioneve apo parashtrimin të pyetjeve.



Kohëzgjatja e vizës



Aplikimet e mëparshme për vizë



Procedura e rregullt për pajisjen e një qytetari të Kosovës me një vizë Shengen zgjat mesatarisht nga 1 deri në 6 muaj. Përbërësisht, në rast të aplikimit në shërbimet konsullore të Kroacisë dhe të Bullgarisë, të cilat nuk lëshojnë viza Shengen, procedura zgjat rreth 1 deri në 6 javë. Rrjedhimisht, për pjesëmarrjen e një studenti në një konferencë ose të një biznesmeni në një panair, planifikimi paraprak është i domosdoshëm (gjë që nuk është gjithmonë i mundshëm). Por, sapo probabiliteti i lartë për refuzim të vizës i shtohet kalkulimit, (ndonëse një gjë e tillë ka shënuar ulje gjatë vitit të fundit), veçanërisht për ata që aplikojnë për herë të parë, rezultati është një dekurajim i madh për të konsideruar një mundësi përtej rajonit. Ose në skenarin tjetër mjaft të shpeshtë, kohëzgjatja e vizës së lëshuar është aq e shkurtër sa që vetëm një ndryshim i datës [që ka të bëjë me ngjarjen apo fluturimin] mund të sjellë në dështimin e gjithë planit. Rrjedhimisht, kosovarët përfundojnë në të njëjtën procedurë burokratike më shumë se një herë në vit, e cila ka një kosto materiale dhe jo materiale.

Përkundër sfidave të paprecedentë, shërbimet konsullore të shteteve të BE-së në Prishtinë, ndërmjet viteve 2016 dhe 2021, kanë pranuar rreth **539,344 aplikime**.⁴⁴ Nëse kostoja mesatare për çdo aplikim është rreth **165 euro**, i bie që qytetarët e Kosovës kanë shpenzuar rreth **89 milionë euro** për të udhëtuar në BE në 6 vitet e fundit. Kjo shumë është mjaft gjigante për një



44 Të dhënat nga Ambasadat e vendeve të BE-së/Zonës Shengen në Prishtinë, gusht-shtator 2022.

vend me një GDP prej 4,986 dollarësh për kokë banori (në 2021) dhe një pagë mesatare prej 484 eurosh (në 2021).⁴⁵

Shuma duket edhe më e madhe kur konsiderohet fakti që pala pranuese është BE-ja (shtetet anëtare), e cila është ofruesi më i madh i fondeve dhe asistencës financiare në Kosovë, që përmes reformave të thella dhe gjithëpërfshirëse ndihmon atë në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në BE.⁴⁶

Kosova do të marrë 63.96 milionë euro nga Korniza e re IPA III (2021-2027).⁴⁷

Së fundmi, BE-ja po dërgon sinjale pozitive për liberalizimin e vizave për Kosovën, por a mund t'ia falin kosovarët BE-së vitet e fundit të izolimit?! Po mundësitë dhe shpresat e humbura?!

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	TOTALI
Zyra Belge							
Kompetencat për viza janë transferuar në Ambasadën e Zvicrës							
Ambasada e Austrisë							
Kompetencat për viza janë transferuar në Ambasadën e Zvicrës							
Ambasada e Bullgarisë	6728	5986	5507	6235	3859	6560	34875
Ambasada e Kroacisë	2717	3414	5019	9557	4804	6221	29015
Ambasada e Republikës Çeke	No data						5282
Ambasada e Finlandës	1450	2723	3927	3158	516	1561	13335
Ambasada Franceze							
Kompetencat për viza janë transferuar në Ambasadën e Zvicrës							
Ambasada Gjermane	26609	29838	32529	32529	9531	18707	161077
Ambasada e Hungarisë	5278	6675	4013	4013	627	291	19816
Ambasada Italiane	5960	5711	5657	5657	1331	1400	25702
Ambasada e Holandës							
Kompetencat për viza janë transferuar në Ambasadën e Zvicrës							
Ambasada e Sllovenisë	3683	4440	4692	4692	1049	798	19187
Ambasada Suedeze	4240	6611	8951	8951	2328	690	34010
Ambasada e Zvicrës	25739	30504	30712	30712	9732	17277	153509
Zyra Ndërlidhëse e Greqisë	6364	7427	6922	6922	1746	4599	34662
Ambasada Mbretërore Norvegjeze	2341	2957	2205	2205	1	No data	8874
Ambasada e Luksemburgut							
Kompetencat për viza janë transferuar në Ambasadën e Zvicrës							
Zyra Ndërlidhëse e Sllovakisë	371	200	183	183	33	33	954
Të gjitha konsullatat							539344

Lëvizja e lirë e mallrave dhe shërbimeve pa lëvizje të lirë të njerëzve

Në vitin 2015, Kosova nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE-në, gjë që u shënuar si moment historik dhe i rëndësishëm në marrëdhëniet e tyre dypalëshe.⁴⁸ Nga perspektiva ekonomike, nënshkrimi i MSA-së ndërmjet Kosovës dhe BE-së, konsiderohet të jetë shtyllë e integritit të fuqizuar ekonomik, që ka për qëllim krijimin e mundësive tregtare dhe të investimeve si dhe hapjen e perspektivës për krijimin e vendeve të reja të punës për qytetarët e Kosovës, veçanërisht për të rinjtë.⁴⁹

Bashkimi Evropian funksionon si një treg i vetëm i 27 shteteve anëtare dhe katër vendeve të EEA-s (Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra), që garanton lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve. Për vendet që aspirojnë të jenë pjesë e BE-së siç janë vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat ende nuk kanë mundësi t'i gëzojnë këto përfitime, BE-ja ka nisur Procesin e Stabilizim Asociimit me qëllim që atyre t'u ofrohet pjesëmarrje e kufizuar në tregun e BE-së.⁵⁰

Duke mundësuar lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe mallrave, MSA-ja 'iu dha' bizneseve kosovare të drejtën për qasje në 500 milionë konsumatorë të 27 shteteve anëtare të BE-së. Që nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, BE-ja

45 GDP për kokë banori, Banka Botërore, në <https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD?locations=XK> Niveli i Pagave në Kosovë, 2021, Agjencia e Statistikave të Kosovës në <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/niveli-i-pagave-ne-kosove-2021>.

46 Projektet e BE-së me Kosovën, EEAS, në https://www.eeas.europa.eu/node/410741_hy?s=321. Nga viti 2007-2020, BE në Kosovë ka investuar më shumë se 1.5 miliardë euro.

47 Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në https://www.eeas.europa.eu/kosovo/eu-and-kosovo_en?s=321

48 Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, Faqja zyrtare e Këshillit të BE-së, 27 tetor 2015, në <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/27/kosovo-eu-stabilisation-association-agreement/>.

49 Parlamenti Evropian, eurodeputetët ratifikojnë Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës në <https://www.europarl.europa.eu/news/en/press-room/20160114IPR09905/meps-ratify-eu-kosovo-association-agreement#:~:text=The%20European%20Parliament%20gave%20its%20consent%20to%20the,and%20economic%20integration%20between%20the%20EU%20and%20Kosovo;> Nënshkruhet Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, Faqja zyrtare Këshillit të BE-së, 27 tetor 2015.

50 Katër liritë e Bashkimit Evropian, në <https://www.grin.com/document/339299>.

hoqi detyrimet doganore për të gjitha produktet industriale të Kosovës, duke zbritur në zero (0) tarifën doganore për eksportin e tyre.⁵¹ E njëjta gjë u aplikua edhe për produktet bujqësore, me përjashtim të mishit, hardhive dhe produkteve të peshkut të cilat iu nënshtrohen kufizimeve të kuotave.⁵²

Mallrat dhe shërbimet e Kosovës kryesisht eksportohen në Gjermani, Slloveni, Greqi, Kroaci, Rumani, Itali, Francë, Hungari, Sllovakia, Finlandë, Austri dhe Zvicër dhe sasia e eksportit ndryshon sipas prodhimit total; disa kompani eksportojnë 100% të totalit të prodhimit ndërsa të tjerat 50% deri në 80% përderisa disa prej tyre vetëm 10%.⁵³

Sidoqoftë, përderisa mallrat dhe shërbimet e Kosovës mund të lëvizin lirshëm, qytetarët nuk mundën dhe një gjë e tillë ka ndikuar negativisht në zbatimin e përgjithshëm të shkëmbimeve tregtare ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Regjimi i vizave po jep një efekt domino edhe për bizneset meqë ato nuk po mund të maksimizojnë në plotëni përfitimet ekonomike të MSA-së. Rrjedhimisht, krahasuar me kompanitë e ngjashme në rajon, kompanitë kosovare janë në disavantazh dhe kanë mundësi të kufizuara për zhvillim.

Kompanitë kosovare, të anketuara nga Grupi për Ballkan, konsiderojnë se **regjimi i vizave ka ndikuar negativisht në qarkullimin e tyre dhe atë nga 15-50%.**⁵⁴

Vendi	Nisja e dialogut për vizat	Hyrja në fuqi e MSA-së	Regjimi pa viza
Shqipëria	01 janar 2008	01 prill 2009	15 dhjetor 2010
Bosnja dhe Hercegovina	01 janar 2008	01 qershor 2015	15 dhjetor 2010
Kosova	19 janar 2012	01 prill 2016	-
Mali i Zi	01 janar 2008	01 maj 2010	19 dhjetor 2009
Maqedonia e Veriut	01 janar 2008	01 prill 2004	19 dhjetor 2009
Serbia	01 janar 2008	01 shtator 2013	19 dhjetor 2009

Me gjithë vështirësitë e shkaktuara nga regjimi i vizave, eksportet e Kosovës vazhdojnë të rriten. Në vitin 2021, eksporti i mallrave ishte 749.7 milionë euro nga të cilat 242.3 milionë euro ose 32.3% e totalit të eksporteve ishin realizuar drejt vendeve të BE-së. Nga ana tjetër, importi i mallrave në po të njëjtin vit (2021) arriti në 4.65 miliardë euro.⁵⁵ Përkundër mallrave, shërbimet janë duke përfomuar shumë më mirë.⁵⁶ Sa i përket Investimeve të Huaja Direkte, ato arritën në 415.3 milionë euro nga të cilat 384.7 ose 92.6% janë në aktivitete të patundshmërive që mund t'i atribuohen kryesisht shpenzimeve të diasporës për pronat.⁵⁷

Viti	Tregtia në mallra		Tregtia në shërbime		Investimet e Huaja Direkte (milionë euro)
	Eksporti (milionë euro)	Importi (milionë euro)	Eksporti (milionë euro)	Importi (milionë euro)	
2021	739.7	4652.7	1954.4	749.7	415.3

Disa nga arsyet kryesore që i shtojnë bizneset kosovare të udhëtojnë në vendet e BE-së janë:

- Pjesëmarrja në panaire biznesi;
- Pjesëmarrja në trajnime profesionale; dhe
- Takimet B2B.

Arsye të tjera po aq të rëndësishme mund të jenë:

- koordinim më i mirë ose i vazhdueshëm me klientët;
- të qenurit në afërsi të problemeve të shfaqura;
- realizimi e takimeve ballë për ballë me klientët potencial;

51 MSA, Kapitulli 1, neni 22.

52 MSA, Kapitulli II, neni 28. Eksporti i verës përjashtohet nga tarifa doganore deri në kufirin e kuotës prej 40 000 hektolitra për verën e rrushit dhe 10 000 hektolitra për verën e gazuar. Tarifa doganore nuk zbatohet për produktet e peshkut deri në 15 tonë për troftë dhe 20 tonë për krapin në vit. Kufizimet e kuotave vlejné vetëm për deri në 475 ton mish (viçi/mish viçi) në vit.

53 Intervistë me përfaqësues nga kompanitë eksportuese në sektorët e mallrave dhe shërbimeve, gusht-shtator 2022.

54 Ibid

55 Të dhënat nga Departamenti i Tregtisë, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Republika e Kosovës, korrik 2022.

56 Të dhënat nga Banka Qendrore e Kosovës.

57 Ibid

- eksplorimi i zhvillimeve të reja në tregtinë ndërkombëtare;
- përcjellja e trendëve të reja dhe inovacioneve në sektorë të caktuar etj.

Ndërsa regjimi i vizave ka pasur rolin e vet në qasjen e bizneseve në mundësi të shumta, disa sektorë të caktuar janë afektuar më shumë, krahasuar me të tjerët.

Marrja e vizës për qëllime biznesi zgjat afërsisht 30-90 ditë dhe kushton afërsisht 140-200 euro

Një kompani e Kosovës që eksporton produkte/shërbime në vendet e BE-së, aplikon për vizë Shengen në baza të rregullta (brenda një viti). Procesi i aplikimit nga caktimi i një takimi deri në marrjen e vizës, zgjat afërsisht 30-90

ditë dhe kushton nga 140-200 euro.⁵⁸

Të dhënat nga intervistat e Grupit për Ballkan me bizneset kosovare tregojnë një trend interesant. Kohëzgjatja e vizës së lëshuar -në shumicën e rasteve- varet nga pozita e punës së aplikantit. Rrjedhimisht, sa më i lartë të jetë pozicioni hierarkik në kompani, aq më të mëdha janë shanset për t'u pajisur me një vizë me kohëzgjatje më të madhe, ndonëse ka raste kur edhe atyre që posedojnë pozita drejtuese menaxheriale i'u jepen viza me validitet vetëm disa ditore.⁵⁹

Përveç kësaj, asnjë nga ambasadat e zonës Shengen nuk i ka thjeshtuar procedurat e lëshimit të vizave për qëllime biznesi. Ambasada e Gjermanisë nga njëra anë, e ka komplikuar procedurën e caktimit të terminit (tre deri në katër muaj pritje për një takim) në anën tjetër e ka zgjatur validitetin e vizave të lëshuara (nga tre deri në pesë vjet).⁶⁰

DMEXCO, Koln, Gjermani (21-22 shtator 2022)

Për disa kompani të Kosovës të cilat ofrojnë shërbime të teknologjisë së informacionit, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MIET)/Agjencia Kosovare për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) ka siguruar një hapësirë për ekspozitë në DMEXCO - panairin kryesor ndërkombëtar të Evropës për marketing dhe reklamim dixhital.

Kjo mundësi e artë për kompanitë e Kosovës, e ofruar me qëllim të vendosjes së kontakteve me kompani të mëdha në sektorin e TI-së, rezultoi në një zhgënjim të madh meqë shumica e pjesëmarrësve nuk mundën të realizonin në kohë termine për viza dhe rrjedhimisht pajisje me vizë për pjesëmarrje në panair.⁶¹

Gjetja e partnerëve të rinj është gjithmonë një sfidë e madhe për një kompani kosovare sepse një gjë e tillë kërkon udhëtime të vazhdueshme e të paplanifikuara në vende të caktuara. Në shumicën e rasteve, produktet e eksportuara në vendet e zonës Shengen kanë procedura shtesë si lansimi i produkteve/shërbimeve ose montimi/lansimi në vendin e destinacionit. Për të shmangur procedurat burokratike të vizave, kompanitë e Kosovës shpesh kontraktajnë ofrues të shërbimeve [në vendin e destinacionit] për t'i kryer këto shërbime në emër të tyre. Një gjë e tillë ngritë çmimin e produkteve në treg e si pasojë i bën kompanitë kosovare më pak konkurruese në krahasim me homologet e vet në rajon.⁶²

Përveç kësaj, kompanitë shpesh kanë nevojë të takojnë klientë të ndryshëm për të ofruar mbështetje ndaj konsumatorit në vendet eksportuese. Natyra e takimeve të tilla kërkon shumë fleksibilitet dhe pamundësia e kompanive vendore për ta përmbush këtë standard, rrezikon marrëdhëniet e tyre me klientët dhe partnerët e huaj.⁶³

Regjimi i vizave ka sjellë një praktikë të vjetërsuar të trajnimit në Kosovë. Për të shmangur procedurat e gjata dhe të kushtueshme të aplikimit për viza, kompanitë po improvizojnë duke punësuar mentorë të huaj për të trajnuar stafin e tyre në Kosovë.⁶⁴ Pavarësisht nga kjo, përfaqësuesit e kompanive të Kosovës besojnë se përfitimet nga kjo praktikë nuk janë asgjë krahasuar me trajnimet që mbahen jashtë vendit (p.sh. në vendin ku është lansuar

58 Intervistë me përfaqësues nga kompanitë eksportuese në sektorët e mallrave dhe shërbimeve; gusht- shtator 2022.

59 Ibid

60 Ibid

61 Intervistë me një përfaqësues të një kompanie në sektorin e TIK, shtator, Prishtinë.

62 Intervistë me një përfaqësues nga një kompani eksportuese në sektorin e metaleve, 19 gusht 2022.

63 Intervistë me një përfaqësues nga një kompani eksportuese në sektorin e metaleve, 25 gusht 2022.

64 Ibid

produkti/shërbimi). Qasja në tregje të avancuara, takimi e ndër-veprimi me kompanitë kryesore të industrisë dhe shkëmbimi i pikëpamjeve dhe praktikave me njerëz përtej kufirit, ndikojnë në forcimin e kapaciteteve të punonjësve dhe integrimin e njohurive të reja praktike në vendet e tyre të punës.

Për bizneset kosovare, regjimi i vizave po ndikon edhe në marrëdhëniet me partnerët dhe klientët nga vendet e BE-së; gjë që po kufizon mundësitë e inovacionit. Çdo takim i porealizuar ndikon negativisht në rritjen e rezultateve të eksportit të një kompanie meqë minimizon partneritetet dhe mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen.⁶⁵

Takimet zakonisht planifikohen shumë kohë më përpara. Megjithatë, nganjëherë sipas rrethanave të caktuara kërkohen udhëtime të paplanifikuara në një vend të BE-së, veçanërisht gjatë prezantimit të produktit ose pjesëmarrjes në një ngjarje të rëndësishme. Ka raste të tjera që për shkak të natyrës së punës kërkohet lëvizje/udhëtim i vazhdueshëm i stafit.⁶⁶ Ka raste të tjera që për shkak të natyrës së punës kërkohet lëvizje/udhëtim i vazhdueshëm i stafit.⁶⁷

Të gjitha këto sfida tregojnë se regjimi i vizave i ka vendosur kompanitë kosovare në disavantazh krahasuar me homologet e tyre në rajon, të cilat janë në gjendje të ofrojnë çmime më konkurruese dhe të mbajnë kontakte të vazhdueshme me konsumatorët /klientët.

Edhe pse mallrave e shërbimeve të Kosovës i ofrohet qasje falas në tregun e BE-së, mungesa e lëvizjes së lirë të njerëzve/komunitetit të biznesit i'a pamundëson Kosovës të shfrytëzojë potencialin e plotë të MSA-së. Lëvizja e lirë e mallrave dhe shërbimeve nuk është e plotë pa lëvizjen e lirë të njerëzve. Fakti që regjimi i vizave nuk u hoq pavarësisht përmbushjes së kriterëve për liberalizim të vizave nga ana Kosovës tregon se vendimet e tilla janë krejtësisht politike. Pra, çfarëdo që do të bëjë BE-ja në vazhdim, nuk do të mund të kompensojë plotësisht humbjet materiale dhe jo materiale që regjimi i vizave i'u ka shkaktuar kosovarëve gjatë viteve të fundit.

Përderisa liberalizimi i vizave do të ofronte mundësi të reja për bizneset e Kosovës që të rrisin eksportet e tyre, disa mbesin të shqetësuar për ikjen e trurit. Sidoqoftë, është interesant fakti që bizneset ende nuk e shohin këtë gjë si kërcënim. Përfaqësuesit e bizneseve në fakt, janë të bindur se fillimisht një gjë e tillë do të mund të kishte një efekt negativ, por që përfundimisht do të mund të hapë perspektiva të reja për të rinjtë dhe ndërmarrësit që të mësojnë drejtpërdrejt nga njohuritë dhe praktikat më të mira të BE-së dhe të njëjtat ti sjellin në Kosovë.

65 Intervistë me një përfaqësues nga një kompani eksportuese në sektorin e metaleve, 25 gusht 2022.

66 Intervistë me një përfaqësues të një kompanie në sektorin e TIK, shtator 2022.

67 Në këto raste, kompanitë në Kosovë detyrohen të kontraktojnë staf nga rajoni, gjë që shumë herë rezulton në pamjaftueshmëri për shkak të paafësisë së tyre. Intervistë me një përfaqësues nga një kompani eksportuese në sektorin e TIK, 5 shtator 2022.

Aneksi I. Lista e vendeve të treta, shtetasit e të cilëve janë të përjashtuar nga regjimi i vizave për qëndrim të shkurtër

LISTA E VENDEVE TË TRETA, SHTETASIT E TË CILAVE JANË PËRJASHTUAR NGA REGJIMI I VIZAVE PËR QËNDRIM TË SHKURTËR			
1. Maqedonia e Veriut	17. Dominika	33. Mauritiusi	49. Timori Lindor
2. Andora	18. Mikronezia	34. Meksika	50. Tonga
3. Emiratet e Bashkuara Arabe	19. Grenada	35. Malaesia	51. Trinidad dhe Tobago
4. Antigua dhe Barbuda	20. Gjeorgjia	36. Nikaragua	52. Tuvalu
5. Shqipëria	21. Guatemala	37. Nauru	53. Ukraina
6. Argjentina	22. Honduras	38. Zelanda e Re	54. Mbretëria e Bashkuar (me përjashtim të shtetasve britanikë siç përmendet në Pjesën 3)
7. Australia	23. Izraeli	39. Panamaja	55. Shtetet e Bashkuara
8. Bosnia dhe Herzegovina	24. Japonia	40. Peru	56. Uruguai
9. Barbadosi	25. Kiribati	41. Palau	57. Holy See
10. Brunei	26. Saint Kitts dhe Nevis	42. Paraguai	58. Saint Vincent dhe Grenadinet
11. Brazili	27. Korea e Jugut	43. Serbia	59. Venezuela
12. Bahamasi	28. Saint Lucia	44. Ishujt Solomon	60. Vanuatu
13. Kanada	29. Monako	45. Seychelles	61. Samoa
14. Kili	30. Moldavia	46. Singapori	
15. Columbia	31. Mali i Zi	47. San Marino	
16. Kosta Rika	32. Ishujt Marshall	48. El Salvadori	
RAJONE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE TË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS			
62. Hong Kong SAR	63. Macao SAR		
SHTETAS BRITANIK QË NUK JANË QYTETARE BRITANIK			
64. Shtetas britanikë (jashtë shtetit)	65. Qytetarët e territoreve britanike jashtë shtetit (BOTC)	66. Qytetarët britanikë jashtë shtetit (BOC)	67. Personat e Mbrojtur Britanik (BPP)
ENTITETET DHE AUTORITETET TERRITORIALE QË NUK NJIHEN SI SHTETE NGA SË PAKU NJË SHTET ANËTAR			
69. Tajvani			

Burimi: Teksti i konsoliduar: Rregullorja 2018/1806 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 nëntor 2018.

Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) është një organizatë e pavarur rajonale, me qendër në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza dhe rekomandime të politikave zhvillimore për një sërë çështjesh të ndërlidhura me shtet-ndërtim; konsolidim institucional e demokratik; integrimin e minoriteteve, dhe marrëdhënieve ndërshtetërore; si dhe integrimin Evropian dhe reformave politike. Ne kemi përvojë në hartimin, raportimin dhe zhvillimin e politikave, qasje strategjike dhe avokim me qeverinë, institucione ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare.

Në thelbin e punës sonë qëndrojnë raportet tona rigorozë, të detajuar dhe të paanshme, të bazuara gjithmonë në hulumtimet në terren. Ne shkojmë përtej qëndrimeve kryesore dhe kërkojmë të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve për politika të cilat janë krijuese, të realizueshme dhe të matshme, për të ndihmuar në zhvillimin e demokracive të forta dhe shoqërive të bazuara në sundimin e ligjit në Ballkanin Perëndimor.

Ne angazhohemi në avokim të nivelit të lartë, si në rajon ashtu edhe ndërkombëtarisht, duke ndikuar njëkohësisht në diskutime mbi politikën, punët e brendshme dhe politika evropiane për Ballkanin Perëndimor.

Për të arritur këtë, Grupi për Ballkan ka dizajnuar instrumente dhe platforma të reja:

Dialogu Politik promovon dialogun e brendshëm të Kosovës, dhe agjendën e krijimit të reformave.

Forumi i Politikave (një Forum i Avokimit të Nivelit të Lartë-Mendimtar) u angazhua për të përmirësuar dialogun midis shoqërisë civile dhe institucionale.

Grupi për Avokim dhe Politika Kosovë-Serbi (një Forum për bashkëpunimin ndërkufitar të shoqërisë civile) synon të komunikojë, promovojë dhe forcojë dialogun drejt normalizimit të plotë midis Kosovës dhe Serbisë, dhe shoqërive të tyre.

Gratë në politikë promovon fuqizimin e grave dhe vajzave; sigurinë dhe gjithë-përfshirjen e tyre; dhe angazhet të forcojë ndikimin e Grupit të Grave në tërë Kosovën.

Platforma për Dialogun promovon procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke informuar publikun më të gjerë dhe duke nxitur debat për marrëveshjet, përfitimet dhe sfidat e Dialogut.

Komponenti i Mbështetjes nga Eksportët siguron mbështetje për qeverinë dhe institucionet kryesore në fushat e politikave, paqes dhe agjendat e shtet-ndërtimit.



Norwegian Embassy